



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2160, datë 14.09.2012

Për

“Miratimin e dokumentave për Këshillim Publik: “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2, datë 21.2.2008 “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” dhe tabelen e pagesave perkatese”

Këshilli Drejtues (*KD*) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*AKEP*), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Enkeleda Bega, në mbledhjen e datës 14.09.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e dokumentave për Këshillim Publik: “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2, datë 21.2.2008 “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” dhe tabelen e pagesave perkatese”

B A Z A L I G J O R E:

1. Gërma k) e nenit 8, neni 110, 114 dhe neni 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr.9918*);
2. Pikat 12 dhe 17 të nenit 21 dhe shkronja f) pika 3 e nenit 23 e “Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendëshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
3. Udhëzuesi “Për procedurat e Këshillimit Publik” miratuar me Vendim nr.1183, datë 10.03.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP;
4. Pika 1.20 e nenit 1 të Rregullores nr. 2, datë 21.02.2008, “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” i ndryshuar;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- Projekt Vendimi;
- Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
- Dokumenti për Këshillim Publik;

si dhe,

Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP, në zbatim të gërmës k) të nenit 8 të ligjit nr. 9918 me anë të Urdhërit nr.828, datë 27.04.2012, ka caktuar Grupin e Punës “Për Amendimin e Rregullores nr. 2, datë 21.02.2008 “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al””;
2. AKEP me qëllim liberalizimin e regjistrimit dhe administrimit të domanit .al, vlerëson rëndësinë e kalimit në sistemin “Regjister/Regjistrues”, me anë të cilit u jepet e drejta e regjistrimit të domain-eve subjekteve të akredituara nga AKEP.
AKEP ndërkohe do të vazdojë të jete regjistrues me qëllim mbrojtjen e interesave të aplikuesve, si dhe do të administrojë regjistrin qendror të të dhënave;
3. AKEP, për realizimin e këtij procesi, çmon si të rëndësishme amendimin e Rregullores Nr. 2, dt. 21.02.2008 “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al””, me rregullat që normojnë regjistrimin nëpërmjet regjistruesve të emrave të domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al, si dhe delegimin e tyre tek një nameserver të regjistruar në AKEP;

4. Për këtë qëllim, AKEP në zbatim të Ligjit Nr. 9918, dt. 19.05.2008 dhe në përputhje me Udhëzuesin e Procedurave për Këshillimin me Publikun miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, Nr. 1183, datë 10.03.2010, në kuadër të transparencës dhe paanësisë nxjerr për Këshillim Publik këtë dokument me propozimet për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2, datë 21.02.2008,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e nxjerrjes së këtij dokumenti, si për AKEP ashtu dhe për sipërmarrësit që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike dhe shoqërisë së informacionit, bazuar në gërmen k) dhe p) të nenit 8, neni 110, 114 dhe neni 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S:

1. Të miratojë për Këshillim Publik dokumentat “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2, datë 21.2.2008 “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” dhe tabelën e pagesave përkatëse”, sipas dokumentave për Këshillim Publik, bashkëlidhur;
 2. Periudha e Këshillimit Publik do të jetë 45 ditë nga data e publikimit të dokumentit në Internet në faqen zyrtare të AKEP;
 3. Ngarkohet Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin nr.828, datë 27.04.2012, për administrimin e procesit të Këshillimit Publik;
 4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al;
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE

PË R M B A J T J A

1. Propozimet e AKEP për disa dryshime në Rregulloren nr. 2	2
2. Aneksi nr. 1	3
3. Tabela nr.1.....	9
4. Tabela nr.2.....	11
5. Formulari i Regjistrimit.....	13
6. Aneksi nr. 2.....	15
7. PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJE PËR KONSULTIM	16

PROPOZIMET E AKEP PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 2, DATË 21.02.2008.

AKEP PROPOZON:

1. Pika 1.20 neni 1 “*Përkufizime*”, fjalia e dytë të ndryshojë si më poshtë:
Kushtet për veprimtarinë e Regjistruësve dhe Formulari i Aplikimit janë sipas përcaktimeve në ANEKS nr. 1 të Rregullores nr. 2;
2. Pika 13.1 e nenit 13 “*Kushtet në zonën .al*”, të ndryshojë si më poshtë:
Të drejtën për të regjistruar një emër:
 - *domain në zonën “.al”, e kanë të gjithë personat natyror, juridik publik dhe privat, si dhe personat fizik tregtarë me rezidencë të aktivitetit tregtarë në Shqipëri dhe të çdo shteti tjetër në botë, të regjistruar si të tillë sipas legjislacionit në fuqi të shtetit përkatës për këtë qëllim;*
 - *nën domain “.com.al”, “.org.al” dhe “net.al”, e kanë vetëm personat juridik publik dhe privat, si dhe personat fizik tregtarë me rezidencë të aktivitetit tregtarë në Shqipëri, të regjistruar si të tillë sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.*
3. Pika 21.1 e nenit 21 “*Regjistrimi i emrit të domain-it*”, të ndryshohet si më poshtë:
21.1 Regjistrimi i emrit të domain-it kryhet nëpërmjet Regjistruësve.
4. Pika 22.2 e nenit 22 “*Kriteret e regjistrimit*” të ndryshohet si më poshtë:
22.2 Aktivizimi i emrave të domain-eve, kryhet pasi është bërë shqyrtimi i aplikimit dhe ka rezultuar në përputhje me Rregulloren.
5. Neni 23 “*Faturimi i pagesave për regjistrimin dhe posedimin e emrave të domain-eve*”, të ndryshohet si më poshtë:
 - Të hiqen pikat 23.1, 23.3, 23.4 dhe 23.7;
 - Tek pika 23.6 togfjaleshi “*Për likuidimin e fatures*”, të zëvendësohet me “*Rinovimin e domain name*”;
6. Pika 25.3 e nenit 25 “*Bllokimi i një emri domain-i*”, të hiqet;

8. Neni 28 të emertohet “*Modifikimi i të dhënave*”, dhe togfjalëshi “Modifikim teknik” të zëvendësohet me “*Modifikim i të dhënave*”, si dhe të hiqet pika 28.2.

8. Tek neni 29 “*Transferimi vullnetar i emrit të domain-it*” të hiqet pika 29.2.

AKEP propozon që të shtohet Aneksi nr. 1 dhe Aneksi nr. 2 në Rregulloren nr. 2, me rregullat dhe kushtet që duhet të plotësojnë Rregjistruesit kundrejt Autoritetit Përgjegjës dhe Aplikuesve apo Poseduesve të domain name.

ANEKSI nr. 1

1. Përkufizime:

EPP- Extensible Provisioning Protocol (EPP) është një protokoll fleksibil i dizenuar për caktimin e objekteve brenda regjistrave në internet;

WHOIS- Eshtë një bazë të dhënash që përmban informacion mbi kontaktet si email, nr. telefoni për poseduesit e një domain name;

2. Regjistruesi për të marrë të drejtën e regjistrimit të domain-eve në zonën .al, nga Autoriteti Përgjegjës duhet të plotësojë këto kushte:

- a) Të jetë i regjistruar pranë QKR;
- b) Të ushtojë aktivitetin e tij si subjekt i së drejtës tregtare në fushën e Teknologjisë dhe Informacionit (T.I.) dhe komunikimet elektronike;
- c) Të këtë minimumi një person të diplomuar në fushën e Teknologjisë dhe Informacionit.
- d) Regjistruesi nuk duhet të jetë subjekt i ndonjë procedure falimentimi sipas legjislacionit në fuqi.

3. Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruesit:

- a) Çdo subjekt që kërkon të akreditohet si regjistrues duhet të paguajë për Autoritetit Përgjegjes një tarifë për procesin e Akreditimit;
- b) Çdo Regjistrues duhet të depozitojë për Autoritetit Përgjegjes një tarifë për çdo vit në mënyrë që të veprojë si Regjistrues;
- c) Çdo Regjistrues duhet të parapaguajë tek Autoritetit Përgjegjes vlerën për 1000 Kredite për të marrë të drejten e veprimit si Regjistrues;
- d) Regjistruesi duhet të njoftohet të rimbushë llogarinë e tij pranë Autoritetit Përgjegjës (Regjistri) në rast se vlera e mbetur është më pak se 100 Kredite;
- e) Regjistruesi mund të depozitojë një kuote e cila mund të jete dhe më e lartë se 1000 (njëmijë) Kredite;
- f) Regjistrimi dhe rinovimi i një domain-i për një periudhë njëvjeçare do të ketë vlerën e 1 (një) krediti.
- g) Vlerat përkatëse për procesin e Akreditimit, për tarifën vjetore, dhe cmimi për 1 (një) kredit do të përcaktohen me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP;
- h) Sistemi i informacionit i regjistruesit duhet të komunikojë me Regjistrin Qendror përmes ndërmjetësimit të një protokolli komunikimi në përputhje me rregullat e komunikimit të vendosura nga Autoriteti Përgjegjës;
- i) Regjistruesi duhet të ofrojë një numër telefoni të arritshëm për 24 orë në 7 ditë kalendarike për 365 ditë të vitit, Autoritetit Përgjegjës, me qëllim që të merret me problemet teknike dhe operative;
- j) Regjistruesi ka të drejtë të regjistrojë domain name vetëm në zonat **.al, .com.al, .net.al, .org.al, edu.al**;
- k) Regjistruesi ka të drejtë për të vendosur çmime konkurruese, ndaj aplikuesve për rregjistrimin e domain name;
- l) Regjistruesi ka detyrimin të veprojë si hallkë lidhëse midis Autoritetit Përgjegjës dhe Aplikuesve duke kryer të gjitha procedurat e përcaktuara në rregullore;
- m) Regjistruesi, ka detyrimin që të marrë të dhënat e kërkuara, në zbatim të rregullores, nga aplikanti dhe ti hedhë ato në regjistrin qendror;

4. Të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Përgjegjës në lidhje me Regjistruesin:

- a) AKEP ka të drejtë të kryejë regjistrimin e Domain Name pavarësisht regjistrimit të domain name nga ana e Regjistruesit;

- b) Të mbaje të dhënat e një Domain Name në Regjistrin Qendor;
- c) Të mbajë të dhënat e një Domain Name të deleguar në zonën.AL;
- d) Të bëjë çdo përpjekje që është e arsyeshme që të sigurojë një funksionim të lirë dhe pa gabime të Regjistrin Qendor dhe Name serverit primar;
- e) Bazuar në aplikimin sipas formularit të aplikimit, AKEP do të lëshojë një certifikatë regjistrimi për sipërmarrësin, brenda 15 ditëve nga data e pranimit të aplikimit të plotë.
- f) Regjistri Qendor mbahet nga Autoriteti Përgjegjës. AKEP është administruesi i të dhënave personale që ndodhen në Regjistrin Qendor. Regjistruesi është procesuesi i këtyre të dhënave;
- g) AKEP administron Regjistrin e Regjistruesve së bashku me historikun e veprimeve, me anën e një baze të dhënash (database).
- h) Regjistri i Regjistruesve që publikohet në faqen e internetit të AKEP do të përmbajë këto të dhëna:
 - Emrin dhe adresën e sipërmarrësit;
 - Numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT);
 - Përfaqësuesi ligjor i regjistruar në QKR;
 - Të dhënat (telefon, fax, email) të kontaktit me AKEP;
 - Numrin dhe datën e lëshimit të Certifikatës nga AKEP,
- i) Autoriteti Përgjegjës, ka të drejtë të ndërmarrë masa teknike me qëllim që të limitojë veprimet direkte online që mund të sjellin destabilizim të sistemit të AKEP edhe nëse masa të tilla mund të çojnë në kufizime të mundësive të shërbimeve të AKEP, funksionimi i Domain Name-ve të regjistruara, name server-eva etj. AKEP nuk mban asnjë përgjegjësi për demtime që ndodhin, por është i detyruar të bëjë çdo përpjekje për të marrë këto masa sa më shpejt të jetë e mundur;
- j) AKEP, ka të drejtë të kryejë inspektime teknike periodike të name server-ave në Nameserver Set dhe të rekordeve të Key Set ku është deleguar një Domain Name;
- k) Autoriteti Përgjegjës është i detyruar të japë, informacionin e shënuar në Regjistrin Qendor si të fshehur, autoriteteve të përcaktuara në K.Pr.P, në përputhje me ligjin në fuqi;
- l) Autoriteti Përgjegjës është i detyruar të sigurojë informacion për të dhënat historike, nëse është e mundur, si dhe për të siguruar vetëm informacion që ka lidhje me Kontakte specifike ose Domain Name specifike.
- m) Autoriteti Përgjegjës ka të drejtë, sipas zgjedhjes, të përmirsojë informacionin që ndodhet në Regjistrin Qendor, për këtë qëllim Autoriteti Përgjegjës ka të drejtë të shkrijë rekordet e Kontakteve të ndryshme vetëm nga identifikuesi i Kontaktit. Në rastin kur Autoriteti

Përgjegjës kryen një shkrirje të tillë, të gjitha lidhjet e Kontakteve të shkriara të Domain Name, Namserver Set, dhe Key Set do të ruhen, kështu që këto të dhëna do të transferohen brenda të dhënave të Kontaktit me Kontaktet e tjera të shkriara në të;

- n) Autoriteti Përgjegjës është i detyruar të komunikojë me Poseduesin, ose personin përgjegjës, për të siguruar çdo informacion që nevojitet për identifikimin e personave në fjalë, në veçanti numrin e kartës të identitetit, domethënë në këte rast të sigurimit të informacionit është i nevojshëm për identifikim e qartë brenda kornizës ligjore. Autoriteti Përgjegjës është i detyruar të sigurojë informacione shtesë të nevojshme me qëllim për vazhdimin e procedurave;

5. Të drejtat dhe detyrimet e Aplikuesit/Poseduesi që aplikon, për të regjistruar një Domain Name apo për të ndryshuar të dhënat që i përkasin Domain Name-it.

- a) I jep të drejtën Autoriteti Përgjegjës që të dhënat e deklarura nëpërmjet një aplikimi të procesojë të dhënat personale të specifikuara në aplikim me qëllimin e ruajtjes dhe administrimit të Regjistrimit Qendror, duke bërë këto të dhëna publike me ndërmjetësimin e Internetit nëpërmjet shërbimeve që ofron ose nga informacioni i mundësuar nga Autoriteti Përgjegjës;
- b) Eshtë përgjegjës për korektësinë e të gjithë të dhënave të deklaruara në aplikimin për rregjistrim që i përkasin personave që përmenden nëse aplikim, dhe deklaror që këto nuk janë emra të mbuluar, duhen të rregjistrohen në Regjistrin Qendror në bazë të aplikimit, dhe ndërmerr miratimin për të bërë çdo ndryshim të personave ose të dhënave që përmbajnë informacione të personave;
- c) Eshtë i detyruar të raportojë çdo ndryshim të dhënave që bëhen në Autoriteti Përgjegjës me ndërmjetësimin e Regjistruesit;
- d) Eshtë i detyruar të veprojë në mënyrë të tillë që në vazhdimin mos të ketë dublikim të rekordeve të Kontakteve që lindin, dhe Kontakteve identike të ndryshme vetëm në identifikues që mbahen në Regjistrin Qendror;
- e) Tabela nr. 2 tregon çfarë pjesë të informacionit që përdoret në rekordet e Domain Name, Kontakteve dhe Namserver Set mund të shënohen si të fshehura. Në rastin kur kjo pjesë e informacionit është e shënuar si i fshehur, do të thotë që nuk është e publikuar për informacionin publik nëpërmjet shërbimit (WHOIS), por e drejta e Autoritetit Përgjegjës për të mbajtur këtë informacion në Regjistrin Qendror dhe për të siguruar arsyet teknike të nevojshme që funksionimi i Regjistrimit Qendror për Regjistruesit të mbetet i paprekur;

6. Informacionet që duhet të sigurojë një Regjistrues janë:

- a) **Nr. telefoni / Nr. Fax** : Numrat e telefonit dhe të faksit duhet të jenë të saktë dhe të plotë bashkë me prefiks;

- b) **E-mail adresa për njoftimet normale:** Duhet të japë një adresë e-mail ku do të dërgohen njoftimet normale. Këtu mund të përfshihen njoftime rreth shërbimeve të reja, njoftime të mirëmbajtjes, si dhe njoftime të tjera të rëndësishme;
- c) **E-mail adresa për njoftimet financiare:** Duhet të japë një adresë e-mail ku do të dërgohen njoftimet në lidhje me kreditet. Pasi bilanci i krediteve të jetë ulur nën nivelin e caktuar mund të ndikojë në aftësinë tuaj për të regjistruar domain-e, adresa e dhënë duhet të jetë e monitoruar në mënyrë aktive;
- d) **E-mail adresa për njoftimet urgjente:** Duhet të japë një adresë e-mail ku do të dërgohen njoftimet nga regjistri .AL. Kjo duhet zakonisht të jetë në një e-mail adrese apo në një kuti postare që është monitoruar vazhdimisht;
- e) **Faqe Interneti (Website URL) :** Duhet të japë URL-në e faqes së internetit të subjektit Web primar të biznesit. Kjo URL do të përdoret për të gjitha referimet nga Regjistri.AL për Regjistruesin në fjalë.

7. Të dhënat për emrin e domain name

- a) Gërmezimi i një Domain Name nuk mund të ndryshohet;
- b) Regjistruesi, i cili kërkon ndryshimin, është përgjegjës në lidhje me AKEP për vërtetësinë, autorizimin dhe vlefshmërinë e një udhëzimi të tillë;
- c) AKEP do të ndryshojë të dhënat në Regjistrin Qendror kundrejt kërkesave të bëra nga persona që ndodhen në të dhënat e Domain Name-ve, Kontakte-ve, Nameserver Set, dhe Key Set, si persona të autorizuar për të kryer ndryshime të tilla, kërkesa duhet të kryehet nëpërmjet Regjistruesit;
- d) Për një Kontakt që është person ligjor, ndryshe nga një person që ndodhet tek të dhënat e Kontakteve, veprimet mund të bëhen dhe nga një person që është i autorizuar të kryejë veprime për llogari të personit ligjor. Në një rast të tillë, një autorizim me shkrim i firmosur dhe vulosur kërkohet për të bërë verifikimin;
- e) Nëse disa kontakte janë futur në të dhënat e Regjistrimit Qendror dhe kanë kompetencë për të bërë të njëjtin ndryshim, atëherë ndryshimi mund të bëhet me kërkesë të kujtdo nga këto kontakte;
- f) Ndryshimi i të dhënave dhe kontakteve për një domain name mund të kryhet vetëm sipas përcaktimeve të parashikuara në Tabelën nr. 1;
- g) Kur bëhet fshirja e regjistrimit të një Domain Name, delegimi i Domain Name përfundon pa procedura të mëtejshme. Kur fshihet caktimi i Nameserver Set të një Domain Name, delegimi i Domain Name terminon pa procedura të mëtejshme;

8. Transferimi vullnetar i emrit te domain-it

- a) Autoriteti Përgjegjës regjistron ndryshimin e Poseduesit të Domain Name me anë të një kërkesë të plotësuar dhe të bërë përmes Regjistruesit të kontraktuar për Domain Name. Regjistruesi i kontraktuar mund të bëjë një kërkesë për ndryshimin e Poseduesit të Domain Name nëse merr një kërkesë me shkrim nga Poseduesi aktual dhe Poseduesi i ardhshëm;
- b) Regjistruesi është i detyruar të marrë aprovimin e Poseduesi të ardhshëm në përputhje me rregulloren aktuale në ditën që do bëhet transferimi i Domain Name;
- c) Nuk ka asnjë detyrim financiar në momentin që bëhet transferimi i Domain Name ndaj Regjistruesit të kontraktuar ose Autoriteti Përgjegjës;
- d) Transferimi i Domain Name nuk ka lidhje as nuk influencon në Datën e Skadimit.

9. Komunikimet e Përbashketa.

- a) Komunikimi midis AKEP dhe mbajtësit të Domain Name kryhet nëpërmjet Regjistruesit të caktuar;
- b) Komunikimi midis AKEP dhe Regjistruesit kryhet sipas përcaktimeve në këtë Rregullore;
- c) Komunikimet e shkruara sipas kësaj Rregullore konsiderohen të rezervuara nëse kryhen me tel ose mënyra elektronike të cilat lejonë marrjen e përmbajtjes së komunikimit ose identifikimin e personit që drejton komunikimin;

10. Revokimi dhe Çregjistrimi i Çertifikatës së Regjistruesit nga Autoriteti Përgjegjës.

- a) Kur Regjistruesi mbyll aktivitetin është i detyruar të njoftojë AKEP-in minimumi 50 ditë para nga data e mbylljes. AKEP verifikon plotësimin e detyrimeve ligjore të Regjistruesit dhe bën çregjistrimin e tij nga regjistri;
- b) Nëse një Regjistrues i regjistruar do të bëjë mbylljen e aktivitetit të tij për shkak të bashkimit me një subjekt tjetër, atehere ai është i detyruar të njoftojë AKEP-in për ngjarjen e pritshme minimumi 50 ditë para ndodhjes;
- c) Regjistruesit në raste se nuk zbatojnë kushtet e vendosura në këtë rregullore, Autoriteti Përgjegjës i lind e drejta e revokimit të Çertifikatës, që i është dhënë Regjistruesit;
- d) Poseduesit e domain name të këtij Regjistruesi kanë të drejtë të kalojnë domain name e regjistruar nga Regjistruesi të cilit i është revokuar autorizimi tek një tjetër Regjistrues aktiv të çertifikuar;
- e) Transferimi i një domain-i nga një Regjistrues tek një tjetër do të ketë vlerën e 1 (një) krediti, subjekti që do të kreditohet është Regjistruesi pritës.

- f) Në rast të mospërputhjeve të përcaktimeve sipas Aneksit nr. 1 me dispozitat e Rregullores nr. 2, datë 21.02.2008, do të mbizotërojnë përcaktimet e Rregullores nr. 2.

Tabela NR. 1

1. Kërkesa për ndryshimin e të dhënave të një Domain Name mund të kryhet vetëm nga Regjistruesi i caktuar vetëm nëse bëhet kërkesë për të ndryshuar Regjistruesin e caktuar, ky ndryshim për Regjistrues mund të bëhet vetëm nga Regjistruesi i caktuar i ri.

Të dhenat	Kontakti i caktuar për ndryshim
Domain Name	Nuk mund te ndryshohet
Poseduesi	Kontakti ne rolin e Poseduesit
Kontakti administrativ	Poseduesi, Kontakti administrativ
Regjistrues i caktuar	Poseduesi, Kontakti administrativ
Nameserver Set	Poseduesi, Kontakti administrativ, Kontakti teknik per Nameserver Set egzistues
Key Set	Poseduesi, Kontakti administrativ, Kontakti teknik per Nameserver Set egzistues
Transferimi	Poseduesi aktual dhe poseduesi i ri
Terminimi ose mbyllja	Poseduesi

2. Ndryshimi i informacioneve të Domain Name:

Të dhënat e Kontakteve mund të ndryshohen nga Kontakti i Regjistrorit të caktuar.

Të dhenat	Kontakti i caktuar për ndryshim
Identifikuesi	Nuk mund të ndryshohet
Të dhëna të tjera	Kontaktet përkatëse

3. Ndryshimi i të dhënave të Nameserver Set

Të dhënat të Nameserver Set mund të ndryshohen nga Regjistruesi i caktuar i Nameserver Set.

Të dhenat	Kontakti i caktuar për ndryshim
Identifikuesi	Nuk mund te ndryshohet
Kontakti teknik	Kontakti teknik
Nameserver	Kontakti teknik
Terminimi ose mbyllja	Kontakti teknik

4. Ndryshimi i të dhenave të Key Set

Të dhënat e Key Set data mund të ndryshohen nga Regjistruesi i caktuar i Key Set

Të dhënat	Kontakti i caktuar për ndryshim
Identifikuesi	Nuk mund të ndryshohet
Kontakti teknik	Kontakti teknik
DS (Delegation Signer) Rekord	Kontakti teknik
Terminimi ose mbyllja	Kontakti teknik

Tabela Nr. 2

Informacioni i detyrueshem dhe ai i mbajtur i fshehur ne recordet e Domain Name-ve, Kontakteve, Namserver Set dhe Key Set.

Domain Name	Te dhenat	Pershkrimi i te dhenave	I detyrueshem	I fshehur
	Emri	Emri i domain-it	A	
	Regjistranti	Emri i perdoruesit	A	
	NS Set	Name server Set		
	Admin	Emri i kontaktit Administrativ		
	Key Set	Key Set		

Kontakti	Të dhenat	Përshkrimi i të dhënave	I detyrueshem	I fshehur
	Subjekti Aplikues	Emri subjektit ose individit		
	Emri	Emri i perdoruesit	A	
	e-mail	Adresa e-mail	A	
	Nr. tel	Numri i telefonit		
	fax	Numri i faksit		
	NIPT	Numri identifikues fiskal		
	Adresa	Adresa postare		
	Identiteti (ID)	Te dhenat e identitetit perkates		A

Nameserver Set	Te dhenat	Përshkrimi i të dhënave	I detyrueshem	I fshehur
	DNS	Lista e DNS-ve	A	

		(e pakta 2 dhe jo me shume se 8)		
	Kontakti Teknik	Te dhenat e kontakteve teknike	A	

Key Set	Të dhenat	Përshkrimi i të dhënave	I detyrueshem	I fshehur
	DNS Key	DNS Key	A	
	Kontakti Teknik	Te dhenat e kontakteve teknike	A	

FORMULARI I APLIKIMIT PER REGJISTRUES

Emri i Kompanise: _____

Adresa: _____

Numri i Telefonit: _____

Numri I Faksit: _____

Adresa e E-mail (per lajmerime normale): _____

Adresa e E-mail (per lajmerime financiare): _____

Adresa e E-mail (per lajmerime urgjente): _____

Faqe e Internetit URL: http://_____

Administratori / Perfaqesuesi Ligjor

Emri : _____ Mbiemri: _____

Adresa: _____

Numri i Telefonit: _____ Numri I Faksit : _____

Adresa e E-mail: _____

Kontakti Administrativ

<i>Vendosni kryq nese Kontakti Administrativ eshte I njejte me Administratorin</i>
--

Emri : _____ Mbiemri: _____

Adresa: _____

Numri i Telefonit: _____ Numri I Faksit : _____

Adresa e E-mail: _____

Kontakti Teknik

Emri : _____ Mbiemri: _____

Adresa: _____

Numri i Telefonit: _____ Numri i Faksit : _____

Adresa e E-mail: _____

Kontakt Pajese

Emri : _____ Mbiemri: _____

Adresa: _____

Numri i Telefonit: _____ Numri i Faksit : _____

Adresa e E-mail: _____

Komente te tjera:

Deklarate e Administratorit / Personit te Autorizuar

Nën përgjegjësi të plotë ligjore, deklaroj se të dhënat, dëshmitë dhe informacioni i paraqitur në formularin e aplikimit dhe çdo lidhje të tij janë të vërteta, të sakta dhe në përputhje me çdo kërkesë të parashikuara ligjërisht mbi përgjegjësinë e vetëdeklarimit. Me marrjen e akreditimit deklaroj se do të zbatoj :

1. Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 **“Per Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë”** dhe aktet nën ligjore të fushës;
2. Kushtet e akreditimit;
3. Kërkesat e Rregullores nr.2 date 21.02.2008, per *“Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”* e ndryshuar.

(Emri, Mbiemri)

(Pozicioni)

(Firma, Vula)

Aneksi nr. 2

LISTA E EMRAVE TE NDALUAR

Mbeshtetur ne Rregulloren “ Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” neni 18 dhe neni 19 pika 3, me poshte gjendet lista e grupfjaleve te ndaluara qe konsiderohen te papershtatshme dhe sensitive per perdorim publik ne emrat e domaineve .AL.

- **Blasfemi (kur perdoren per fyerje te ketij karakteri)**
- **homoseksual**
- **identitet seksual (karakter fyerje)**
- **fyerje familjare**
- **organet e riprodhimit njerezor (karakter fyerje)**
- **sharje**
- **fyerje me emra kafshesh**
- **prostitucion (kur perdoret per fyerje te ketij karakteri)**
- **semundje ngjitese (kur perdoren per qellim fyerje)**
- **fyerje raciale**
- **fyerje etnike**
- **fyerje per shkak te semundjeve mendore**
- **fyerje me baze fetare**
- **fyerje politike me terma cifute, naziste etj.**
- **fyerje personale**
- **fyerje te inteligjences**
- **fyerje te kategorish te ndryshme grupfjalesh**

Tabela e e pagesave për regjistrimin e domain cc. TLD nga Regjistruesit

Pagesat qe Regjistruesit duhet te kryejne ne AKEP, te jene si më poshtë:

a. Vlera e Akreditimit, per çdo subjekt që kërkon të veprojë si regjistrues 20 000 Leke (pagese e cila kryhet vetem nje here te vetme);
b. Vlera vjetore, qe cdo subjekt i akredituar duhet të depozitojë paraprakisht per AKEP në mënyrë që të veprojë si Regjistrues 100 000 Leke;
c. Cmimi i 1 (një) krediti ne vit për Regjistruesit ne 70% te vleres te aktuale vjetore te nje domain qe aplikon AKEP.

PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJEVE PËR KONSULTIM:

Pyetje nr.1

Cili është mendimi Juaj në lidhje me propozimet e mësipërme?

Pyetje nr. 2

A mendoni se duhen bërë ndryshime të tjera në dispozitat e Rregullores Nr.2, për implementimin e sistemit të rregjistrimit të domain name-ve nëpërmjet Regjistruesve?

Pyetje nr.3:

A mendoni se janë të mjaftueshme kushtet e vendosura për ndryshimin e të dhënave të cilat lidhen me një domain name?

Pyetje nr.4:

A mendoni se kushtet e vendosura me sipër për publikimin dhe mbajtjen e fshehtë të informacionit janë të mjaftueshme?

Pyetje nr.5:

A mendoni se kushtet që duhet të plotësojnë Regjistruesit për tu certifikuar janë të mjaftueshme?

Pyetje nr.6

Ju lutem jepni mendimin tuaj në lidhje me cmimet e propozuara nga AKEP për Regjistruesit?

Pyetje nr.7

A mendoni se informacioni që duhet të sigurojë një Regjistrues pranë AKEP është i mjaftueshem?

Pyetje nr.8

Cili është mendimi juaj për të dhënat e kërkuara në “Formularin e Aplikimit për Regjistrues”?

Pyetje nr. 9

A jeni dakort me listen e emrave te ndaluar, mendoni se duhet shtuar ndonje percaktim apo kategori ne kete liste?